



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B1 ATK në 326 raste kishte vonesa në trajtimin e kërkesave të tatim paguesve për kthim /rimbursim tatimor mbrenda afatit ligjor;
- C1 Përfitimi i më shumë se një pensioni nga skemat pensionale;
- C2 Përfituesit e pensioneve dhe ndihmave sociale nga personat e punësuar dhe pensionet e paguara pas vdekjes; dhe
- A1 Pagesa e furnizimeve para pranimit të tyre.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat ishin efektive, me perjashtim të vonesave në shqyrtimin e kërkesave të tatimpaguesve për kthim/rimbursim tatimor. Ndërsa kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë.

Mangësitë kryesisht janë vërejtur në pagesën e furnizimeve para pranimit të tyre dhe klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve.

Këtë vit është vërejtur një rënie e gabimeve financiare në lidhje me pensionet e paguara pas vdekjes dhe përfituesit e më shumë se një pensioni. Ndërsa, për pagesat e pensioneve për personat e punësuar ka pasur një rritje krahasuar me vitin paraprak, prandaj menaxhimi i tyre vazhdon të mbetet sfidë.

Menaxhimi i pasurisë mbetet ende sfidë për tu adresuar plotësisht pasi që nuk është kryer me kohë inventarizimi i pasurisë në administratën e Ministrisë si dhe disa pasuri nuk janë regjistruar sipas rregullores. Po ashtu, detyrimet kontingjente nuk ishin prezantuar drejtë pasi regjistrat ishin jo të saktë dhe jo të plotë.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, tre (3) të përsëritura dhe katër (4) pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Vonesë në shqyrtimin e kërkesave për kthim/rimbursim tatimor nga ATK

Gjetja Neni 26 i ligjit nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore obligon ATK-në që brenda 30 ditëve të shqyrtoj dhe aprovoj kërkesën nga tatimpaguesit për kthim/rimbursim tatimor. Nëse kërkesa për kthim/rimbursim është aprovuar nga ATK mirëpo është tejkaluar afati ligjor, atëherë duhet të paguhet edhe interes tatim paguesve për vonesa.

Nga testimet dhe analiza e bazës së kthimeve/rimbursimeve, identifikuam 326 raste ku ATK nuk i kishte shqyrtuar kërkesat e tatim paguesve për kthim/rimbursim tatimor brenda afatit ligjor. Këto vonesa ishin nga 1 deri në 270 ditë kalendarike përtej afatit ligjor. Për këto vonesa, ATK nuk kishte aplikuar pagesën e interesit ndaj tatim paguesve.

Në raport me vitin paraprak numri i rasteve të shqyrtuara me vonesë ishte rritur për 241 (në 2023 kishin qenë 85 raste).

Trajtimi i kërkesave për kthime/rimbursime nga ATK nuk ishte mjaftueshëm efektiv. Shkurtimi i afatit për shqyrtimin e kërkesave nga 60 ditë në 30 ditë me ligjin e ri (Ligji nr. 08/L-257) dhe sipas menaxhmentit edhe mungesa e kapaciteteve me staf ishin shkaktarët kryesor të këtyre vonesave.

Ndikimi Vonesat në kthime/rimbursime tatimore, ju shkaktojnë bizneseve vështirësi financiare në ushtrimin e aktiviteteve të tyre operative dhe në anën tjetër rrisin rrezikun e padive të tatim paguesve ndaj ATK-së si pasojë e mos pagesës së interesit.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të sigurojë përmes drejtorit të ATK-së menaxhim efikas në procesin e shqyrtimit të kërkesave për kthime/rimbursime, në mënyrë që të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar ligjor. Po ashtu, të analizoj shkaqet që kanë shkaktuar ngecjen, përfshirë kapacitetet aktuale, dhe të ndërmarë veprime përkatëse për adresimin e tyre duke shtuar fokusin në trajtimin e kërkesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Përfitimi i më shumë se një pensioni nga skemat pensionale**Gjetja**

Ligji Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, rregullon pensionet bazë të moshës, pensionet kontribut pagues të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalidore të punës. Sipas nenit 16 të këtij ligji, personat të cilët janë përfitues të cilitdo pension të skemave të përcaktuara me këtë ligj në asnjë rrethanë, nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni tjetër nga skemat e veçanta pensionale të cilat menaxhohen nga shteti.

Sipas ligjit Nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L054 për Statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre - neni 5.1.4 përfituesit e pensioneve familjare, invalidor personal dhe invalidor familjar nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të aplikueshme në Kosovë, përveç nëse ndryshe është e përcaktuar me ligj.

Sipas ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e UÇK-së neni 16 pika 2, Veteranët e UÇK-së nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse veterani është shfrytëzues i ndonjë skeme pensionale të financuar nga shteti duhet të përcaktohet se cilin pension do ta marrë.

Sipas ligjit Nr. 04/L-084 për pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, neni 5.3 përfituesit që kanë të drejtë në pensionin e FSK-së duhet të zgjedhin njërin nga përfitimet: pensionin që u takon me këtë ligj, apo përfitimet tjera që parashihen me ligjet tjera në fuqi.

Për këtë qëllim është e rëndësishme të theksohet se Ligji nr.03/L-100 për Pensionet e pjesëtarëve të TMK-së nuk ka ndonjë dispozitë ligjore e cila në mënyrë të qartë ua njeh të drejtën e vazhdimit të marrjes së pensionit të TMK-së nëse personat e njëjtë gëzojnë edhe ndonjë pension tjetër nga skema pensionale.

Bazuar në krahasimin e të dhënave të Ministrisë për skemat pensionale dhe sociale kemi identifikuar se Ministria kishte kryer pagesa në vlerë 1,140,836€ për përfitues të cilët gëzojnë më shumë se një pension. Krahasuar me vitin e kaluar kishte një ulje të gabimit financiar sidomos nuk kishte asnjë pagesë për pensionet e FSK-së. Rastet më të shpeshta të përfitimit të më shumë se një pensioni nga skemat pensionale, janë përfituesit që i takojnë kategorisë së TMK-së, të cilat pagesa Ministria i kishte kryer edhe vitin e kaluar bazuar në vendimin e ish Kryeministrit nr. 12/82 të datës 28.12.2018. Me këtë vendim ishte aprovuar vazhdimi i pagesave të pensioneve të dyfishta për FSK dhe ish-pjesëtarët e TMK-së deri në interpretimin përfundimtar të ligjeve për skemat pensionale.

Tabela 1. Përfituesit e më shumë se një pensioni nga skemat pensionale

Nr	Lloji I Skemës	Numri I pagesave	Gabimi Financiar (EUR)
1	Pensionet e Forcës Së Sigurisë së Kosovës FSK dhe DFDIL Familjar	-	-
2	Pensionet e Forcës Së Sigurisë së Kosovës FSK dhe DFDIL Veteran	-	-
3	Pensionet e Trupave të Mbrojtjes së Kosoves TMK dhe DFDIL Familjar	5,067	1,064,727
4	Pensionet e Trupave të Mbrojtjes së Kosoves TMK dhe DFDIL Veteran	10	1,190
5	Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL Familjar	3	300
6	Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL Veteran	-	-
7	Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL Familjar	453	74,619
8	Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL Veteran	-	-
9	Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar (PPAK) dhe DFDIL Familjar	-	-
10	Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar (PPAK) dhe DFDIL Veteran	-	-
11	DFDIL Familjar dhe PIP	-	-
12	Trepça dhe DFDIL Veteran	-	-
13	KV dhe DFDIL Familjar	-	-
Gjithsej		5,533	1,140,836

Shkak për këtë gjendje ishte mungesa e interpretimit përfundimtar të ligjeve për skemat pensionale.

Ndikimi Pagesat e pensioneve të dyfishta për personat e njëjtë pa një interpretim të bazës ligjore nga organet përgjegjëse mund të dëmtojnë buxhetin e Ministrisë.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të iniciojë procedurat për të bërë interpretim dhe vlerësim të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore në lidhje me pensionet e dyfishta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C2 - Përfituesit e pensioneve dhe ndihmave sociale nga personat e punësuar dhe pensionet e paguara pas vdekjes

Gjetja Sipas nenit 10.4.2 të ligjit Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga Shteti, pensionet e parakohshme "Trepça" ndërpriten së paguari, nëse personi punësohet apo vetëpunësohet. Më tutje, sipas nenit 16.4 të ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e UÇK-së - Veteranët e UÇK-së të cilët janë të punësuar në sektorin publik dhe privat nuk kanë të drejtë të përfitimit të pensionit, si dhe sipas nenit 4.4 të ligjit Nr.04/L-096 për skemën e ndihmës sociale ndalon të drejtën për ndihmë sociale për persona të punësuar.

a) Përfitimi i pensioneve nga personat e punësuar - Nga krahasimi i të dhënave të MFPT-së për skemat pensionale dhe ndihmat sociale me të dhënat e ATK-së, kemi vërejtur se ekzistojnë raste të përfitimit të pensioneve apo ndihmave sociale nga persona të cilët punojnë apo realizojnë të ardhura personale. Vlera e gabimit financiar për vitin 2024 ishte 233,931€.

Tabela 2. Përfitimet e pensioneve nga personat e punësuar

Nr	Lloji I Skemës	Numri I pagesave	Gabimi Financiar (EUR)
1	Ndihma Sociale	416	51,880
2	Pensionet Trepca	12	1,613
3	DFDIL Veteran	1,077	180,438
Gjithsej		1,505	233,931

Sipas Ligjeve përkatëse të skemave pensionale dhe rregullave të aplikueshme, pensionet duhet të ndalen pas vdekjes së përfituesve. b) Pensionet e paguara pas vdekjes - Nga krahasimi i të dhënave/regjistrave ndërmjet MFPT-të dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil kemi gjetur se gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithsej 437 pagesa, në vlerë 58,750€ për pensione pas vdekjes së përfituesve.

Tabela 3. Pensionet e paguara pas vdekjes

Lloji I pensionit (Skemes Pensionale)	Pagesat për përfituesit që kanë vdekur para vitit 2024		Pagesat për përfituesit që kanë vdekur gjatë vitit 2024		Gjithsej pagesat pas vdekjes së përfituesve	
	Numri i pagesave	Shuma (€)	Numri i pagesave	Shuma (€)	Numri i pagesave	Shuma (€)
Skema e të verberve	0	0.00	9	2,300	9	2,300
Pensionet Bazë	49	5,000	151	17,900	200	22,900
Pensionet Kontributive	12	2,494	53	11,814	65	14,308
Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar (PPAK)	16	1,900	54	5,720	70	7,620
Pensionet e Parakohshme të Trepçes	-	-	2	277	2	277
Arsimi	14	946	40	3,698	54	4,644
Pensionet e TMK-se	-	-	-	-	-	-
DFDIL Veteran	3	510	21	3,468	24	3,978
Pensionet për Paraplegjiket dhe Tetraplegjiket (PPTP)	-	-	13	2,723	13	2,723
Totali	94	10,850	343	47,900	437	58,750

Pagesat pas vdekjes së përfituesve, ndodhin kryesisht si rezultat i

lajmërimin me vonesë apo edhe kur vdekjet e përfituesve nuk ishin regjistruar me kohë në ARC, dhe ministria nuk kishte informata për rastet.

Ndikimi

Përfitimi i pensioneve nga personat e punësuar dhe mbetja e personave të vdekur në listat e pagesave shkaktojnë pagesa të parregullta, duke dëmtuar kështu buxhetin e Ministrisë.

Rekomandimi C2

Ministri duhet të analizojë në hollësi çështjen e pagesave më sipër dhe të shqyrtoj mundësitë për kthimin e tyre nga shfrytëzuesit në llogarinë e buxhetit. Gjithashtu duhet të siguroj forcimin e kontroleve të brendshme në mënyrë që të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet databazave të skemave pensionale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Pagesa e furnizimeve para pranimit

Gjetja

Me nenit 13 të Ligjit të Buxhetit nr. 08/L-260 për vitin 2024, parashihet se OB-të mund të iu paguajnë paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale dhe për mallra dhe shërbime deri në pesëmbëdhjetë përqind (15%) të vlerës ë kontratës.

Në bazë të Nenit 23, paragrafi 3 të Rregullores Financiare Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i Parave Publike, përcaktohet se: "Pranimi i mallit apo shërbimit duhet të bëhet nga zyrtari ose komisioni i autorizuar."

Gjithashtu, sipas Nenit 25, paragrafi 1 të së njëjtës rregullore, specifikohet se: "Para se të regjistrohet një shpenzim në SIMFK, dokumentacioni për pagesë duhet të dorëzohet te zyrtari certifikues. Ky zyrtar është përgjegjës që dokumentacioni të jetë i kompletuar dhe të përmbajë: zotimin/kërkesën për blerje, shpalljen e tenderit, kontratën, urdhërblerjen, raportin e pranimit, faturën e pranuar. Po ashtu, ai duhet të sigurohet që kushtet përkatëse të kontratës publike janë përmbushur para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK dhe autorizimit të pagesës.

Pagesa e plotë për furnizim me vetura në vlerë 679,350€ ishte kryer si paradhënie ndaj operatorit ekonomik, para se të bëhej pranimi i furnizimeve. Pagesa ishte kryer me datë 24.12.2024 kurse furnizimi ishte bërë me datë 16.01.2025. Sipas Rregullores Financiare Nr. 01/2013/MF në fuqi, nuk lejohet pagesa pa pranimin paraprak të mallit apo shërbimit nga zyrtari apo komisioni i autorizuar.

Para kryerjes së pagesës, ATK dhe operatori ekonomik kishin nënshkruar një marrëveshje shtesë, me të cilën obligohet operatori të ofroj një garancion bankar (OE e kishte ofruar garancionin bankar), që mbulonte tërë vlerën e pagesës duke garantuar përmbushjen e furnizimeve brenda afatit dhe në përputhje me kushtet kontraktuale.

Qëllimi i këtij veprimi sipas ATK-së ishte të sigurohej plotësisht që në rast të mosrealizimit të furnizimeve të ketë mundësinë e konfiskimit të mjeteve financiare nga banka që ka ofruar garancionin.

Sipas dokumentacionit të shqyrtuar dhe informacioneve të pranuar pagesa në këtë formë është realizuar për shkak të mungesës së theksuar të

automjeteve për punë në terren, shfrytëzimit të mjeteve financiare të planifikuara të vitit 2024 për këtë projekt, dhe faktit që në buxhetin për vitin 2025 nuk kishte mjete në dispozicion për këtë projekt.

Ndikimi

Shpenzimet për furnizimet e papranuara jo në pajtim me rregullën për shpenzimin e parave publike ndikon që pasqyrat financiare të mos jenë të prezantuara drejt pasi që kemi mbivlerësim të shpenzimeve kapitale duke mos rezultuar me pranim të pasurisë.

Rekomandimi A1

Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së duhet të forcojnë kontrollet e brendshme dhe të sigurohen se praktikat e tilla të pagesave nuk aplikohen në të ardhmen. Po ashtu, para ekzekutimit të çdo pagese të sigurohen se janë pranuar furnizimet me qëllim që të arrihen objektivat për të cilin është shpenzuar paraja publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Gjatë vitit 2024 ishin paguar dhe regjistruar shpenzimet në kategori ekonomike joadekuate në vlerë prej 90,516€ si në vijim:

- Shpenzimet me vendime gjyqësore nga MFPT në vlerë prej 43,510€ për pensione bazike dhe pensione të aftësisë së kufizua ishin paguar nga kategoria e investimeve kapitale dhe mallra dhe shërbime edhe pse për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve;
- Pagesa në vlerë 47,936€ për furnizim me pajisje për Qendrat për Aftësim Profesional (Agjencia e Punësimit) pjesa prej 43,736€ i përket pajisjeve nën 1,000€ dhe sipas vlerës individuale të pajisjeve dhe natyrës i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Kjo pagesë është realizuar nga kategoria e investimeve kapitale; dhe
- Pagesa në vlerë 3,270€ për blerjen e klimave për Njësinë e Intelgjencës Financiare i përket pajisjeve nën 1,000€ dhe sipas natyrës i takon kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Kjo pagesë është realizuar nga kategoria e investimeve kapitale.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos planifikimit të duhur në kategori përkatëse gjatë ndarjes së mjeteve financiare me Ligj të Buxhetit dhe mungesës së kontrolleve.

Ndikimi

Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar /nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse.

Rekomandimi B2

Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i tyre bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate. Po ashtu, pagesat me vendime gjyqësore duhet të realizohen nga kategoria adekuate e shpenzimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 24,114,185€, pasurive jokapitale është 884,793€, si dhe e stoqeve 647,932€.

Çështja B3 - Mos kryerja e procesit të inventarizimit të pasurisë me kohë

Gjetja

Sipas Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 19, thekson se raporti i inventarizimit duhet të përgatitet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Administrata e MFPT-së, nuk kishte arritur të kryej procesin e inventarizimit para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore (inventarizimi i pasurisë ka përfunduar me datë 05.03.2025) dhe rrjedhimisht nuk kishte bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurive jo financiare.

Edhe pse komisioni ishte formuar në kohën e duhur, shkak i mos inventarizimit ishte neglizhenca e komisionit dhe kontrollet jo efektive të menaxhmentit në lidhje me këtë proces.

Ndikimi

Mos kryerja e inventarizimit të pasurisë ndikon në mos verifikimin e saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurive të Ministrisë. Po ashtu, kjo rritë rrezikun që ndryshimet eventuale të konstatuara nga procesi i inventarizimit të mos reflektohen në regjistrat e pasurive të prezantuara në Pasqyra Financiare.

Rekomandimi B3

Ministri, duhet të siguroj se para përgatitjes së pasqyrave financiare të bëhet inventarizimi i gjithë pasurisë në kuadër të MFPT-së si dhe krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV për vitin 2025.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mangësi në regjistrimin e pasurive

Gjetja

Sipas nenit 6, pikës 3 të Rregullores MF - Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Kurse neni 5 i të njëjtës rregullore e përcakton klasifikimin që duhet aplikuar për regjistrimin e pasurive.

Nga testimet dhe analizat e regjistrat të pasurive kemi identifikuar se pasuritë e Ministrisë ishin të nënvlerësuara për 34,905€ (pasuritë të nënvlerësuara ishin për 41,536€ ndërsa të mbivlerësuara për 6,631€). Informatat detaje mund të shihen si në vijim:

- Në Doganën e Kosovës pagesa në vlerë 41,536€ për zhvillimin, avancimin dhe mirëmbajtjen e sistemit nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë; dhe

- Tri vetura të pranuar si donacion në vitin 2006 në vlerë 6,631€ ishin regjistruar gabimisht në regjistrin e pasurive si investim në vijim. Mbajtja e tyre në regjistrin e pasurive si investime në vijim ka pamundësuar zhvlerësimin e tyre nga sistemi (tani më vlera e tyre duhej të ishte zero) duke shkaktuar mbivlerësim të vlerës së pasurive.

Dobësitë në regjistrin kontabël të pasurive kanë ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme, për sa i përket fushës së pasurisë.

Ndikimi

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë të pasurive dhe raportimi jo i duhur i tyre pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nën nënvlerësim të pasurive duke rezultuar edhe në prezantimin jo të drejtë të tyre në pasqyra financiare.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitë brenda MFPT-së bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë e drejtë dhe e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Të arkëtueshmet

Ministria në PFV e vitit 2024 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 649,786,592€. Kjo vlerë përbehet nga të arkëtueshmet e Doganës së Kosovës prej 54,186,121€, nga të arkëtueshmet e ATK-së prej 594,162,671€ dhe Inspektoriatit të Punës 1,437,800€.

Çështja C3 - Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme/ borxheve të vjetra

Gjetja

ATK për vitin 2024 në planin e punës kishte përcaktuar që të inkasohen borxhet në vlerë 247,607,152€. Po ashtu, në planin punës ishte paraparë ndërmarrja e iniciativave për të pastruar stokun e borxhit nga të gjitha borxhet e pa mbledhshme. ATK kishte bërë progres në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme (borxheve të reja). Në vitin 2024 ishin mbledhur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 211,780,485€ apo 85.5% nga ajo që ishte planifikuar. Për nga vlera e mbledhur kishte një rritje prej 9.25% krahasuar me vitin paraprak pasi që në vitin 2023 ishin mbledhur 193,848,973€. Megjithatë, gjatë vitit 2024 ATK nuk ka treguar efikasitet në mbledhjen e borxheve të vjetra (borxhet e pa mbledhshme), pasi që vlera e tyre në fund të vitit 2024 ishte rritur për 1,841,346€ krahasuar me vitin paraprak (në vitin 2024 vlera e tyre ishte 138,304,341€, kurse në 2023 ishte 136,462,995€).

Rritja vjen nga aplikimi i ndëshkimeve dhe interesit që aplikohen në sistem. Rritja e stokut të borxhit të vjetër është një sfidë e vazhdueshme e cila është kryesisht e ndikuar nga pushimi i aktivitetit të operimit të bizneseve.

Ndikimi

Niveli i ulët i arkëtimit të borxheve të vjetra rritë stokun e borxheve të akumuluar, të cilat me kalimin e kohës shndërrohen në borxhe të pambledhshme.

Rekomandimi C3

Ministri përmes Drejtorit të ATK-së duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime më efektive në inkasimin e këtyre borxheve. Për më tepër, përpjekje shtesë nevojiten në trajtimin e stokut të borxheve të vjetra, apo të ndërmirren veprime konkrete që kjo çështje të rregullohet me bazë ligjore përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2024, ishte 6,893,779€.

Çështja C4 - Mangësi në prezantimin e detyrimeve kontingjente

Gjetja Rregullorja MF nr.01/2017, neni 18 obligon Organizatat buxhetore të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente në PVF. Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen.

Regjistri i detyrimeve kontingjente të MFPT-së dhe rrjedhimisht edhe PFV-të, ishte mbivlerësuar për 78,104€, për shkak se tri lëndë të paraqitura si detyrime kontingjente, nga testimet tona ishte verifikuar që ato ishin paguar gjatë vitit 2024.

Mos përditësimi i listës së detyrimeve kontingjente nga zyra ligjore me të dhënat e fundit nga proceset kontestimore ishte shkaktari kryesor i mbivlerësimit të detyrimeve kontingjente.

Ndikimi Mos raportimi i saktë i detyrimeve kontingjente ka ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve kontingjente në PFV.

Rekomandimi C4 Ministri, duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontingjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 4. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	931,025,963	916,578,277	863,933,407	823,917,867	752,789,075
Grante Qeveritare - Buxheti	889,253,963	874,890,752	844,815,172	789,689,804	752,437,041
Financimi përmes huamarrjes	17,500,000	17,050,000	1,385,937	6,553,522	253,858
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	24,272,000	24,172,000	17,368,410	22,631,590	0
Fondi zhvillimor në mirëbesim	0	0	0	4,773,878	0
Donacionet vendore	0	166,222	153,000	114,750	0
Donacionet e jashtme	0	299,302	210,888	154,323	98,176

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 14,447,686€. Kjo zbritje është rezultat i zvogëlimit të buxhetit përmes grantit qeveritar.

Në vitin 2024 MFPT ka shpenzuar 94% të buxhetit final ose 863,933,407€, me një përmirësim 6% në krahasim me vitin 2023. Zbatimi i buxhetit nga financimi përmes huamarrjes dhe klauzoles së investimeve mbetet në një nivel të pakënaqshëm. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 5. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	931,025,963	916,578,277	863,933,407	823,917,867	752,789,075
Pagat dhe mëditjet	23,752,166	22,346,484	21,517,579	21,364,773	21,503,106
Mallrat dhe shërbimet	14,445,000	12,311,975	9,190,508	9,062,167	8,269,524
Komunalitë	1,205,077	741,077	497,550	391,981	470,088
Subvencionet dhe transferet	840,784,968	863,370,147	827,845,998	788,767,186	721,195,040
Investimet Kapitale	50,838,752	17,808,594	4,881,773	4,331,759	1,351,318

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,405,682€ përmes vendimeve të Qeverisë dhe kursimeve buxhetore. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 96% ;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,133,025€ përmes vendimeve të Qeverisë dhe kursimeve buxhetore. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 75%;
- Buxheti final për komunalitë krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 464,000€ përmes vendimeve të Qeverisë. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 67%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 22,585,179€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendime të Qeverisë, dhe përmes donacioneve ku kishte rritje të buxhetit për 23,035,179€ në anën tjetër kishte zvogëlim nga huamarrja në vlerë 450,000€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 96%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 33,030,158€. Investimet kapitale ishin zvogëluar për 15,562,825€ me vendime të Qeverisë, nga klauzola e investimeve kishte zvogëlim për 17,468,410€ ndërsa nga donacionet kishte rritje prej 1,077€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte vetëm 4,881,773€ apo 27%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e planifikuara për MFPT sipas Ligjin nr. 08/L-260 për ndarjet buxhetore për vitin 2024 ishin 2,664,341,000€. Nga kjo vlerë MFPT përfshirë (Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore) kishte arritur të realizonte të hyra neto 2,725,294,662€.

Të hyrat për vitin 2024 për Doganën e Kosovës kanë qenë në vlerë prej 1,832,690,554€, ndërsa në vlera neto realizimi ishte 1,830,170,253€, (të hyrat bruto 1,832,690,554€- 2,520,301€ kthimet). Krahasuar me vitin 2023, këtë vit kishte rritje për 9.5%.

Ndërsa, Administrata Tatimore e Kosovës kishte arritur të realizonte 954,221,756€, ndërsa në vlera neto realizimi ishte 882,593,591€, (të hyrat bruto 954,221,756€ - 71,628,164€ kthimet). Krahasuar me vitin e kaluar, të hyrat në përgjithësi kanë pësuar rritje për 11.3%.

Sa i përket njësive të tjera, Thesari i Kosovës ka inkasuar 10,436,549 €, duke shënuar një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin e kaluar. Kjo rritje është rezultat i marrëveshjes ndërmjet Thesarit dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) për investimin në depozita, ku për mjetet e grumbulluara në vlerë prej 7,577,870 €, BQK-ja i ka paguar Thesarit interesin e përlllogaritur për depozitën e afatizuar.

Tabela 6. Të hyrat (në €)

Agjencitë / Departamenti	Të hyrat bruto	Kthimet	Të hyrat neto 2024	Të hyrat neto 2023	Të hyrat neto 2022
Totali i të hyrave	2,799,443,127	-74,148,466	2,725,294,662	2,466,504,812	2,188,900,388
Administrata tatimore e Kosoves	954,221,756	-71,628,164	882,593,591	792,802,901	659,261,218
Dogana e Kosoves	1,832,690,554	-2,520,301	1,830,170,253	1,671,083,921	1,528,853,806
Inspektoriati i Punës	1,764,210	0	1,764,210	1,138,140	587,018
Administrata Thesari i Kosovës	10,436,549	0	10,436,549	1,231,611	43,125
Agjencia Qendrore e Prokurimit	81,866	0	81,866	29,171	0
Administrata Qendrore - MF	207,757	0	207,757	59,720	96,588
Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale	0	0	0	0	3,030
Shërbimet e punësimit	37,154	0	37,154	32,220	35,970
Njësia e Inteligjencës Financiare	3,281	0	3,281	127,128	19,633

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të MFPT ka rezultuar në nëntë (9) rekomandime. MFPT ka përgatitur Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, një (1) rekomandim është zbatuar, katër (4) ishin në proces, tre (3) nuk janë zbatuar ende dhe një (1) nuk është i aplikueshëm më, siç është paraqitur në Grafikon 2.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 7 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 7. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj menaxhim efikas në procesin e kthimeve/rimbursimeve, në mënyrë që kërkesat për rimbursim të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar ligjor. Në rastet e vonesave nga ATK duhet të aplikohet pagesa e interesit për tatim paguesit.	Edhe këtë vit kemi hasur në raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri përmes Sekretarit të Përgjithshëm, duhet të siguroj vazhdimin e marrjes së veprimeve ligjore (përmbarmore) ndaj personave përgjegjës të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuar - avanset.	Ky rekomandim konsiderohet i mbyllur për vitin 2024 pasi që MFPT në planin e veprimit për zbatim të rekomandimeve ka caktuar vitin 2026 për implementin të tij. Ministria është duke ndaluar mjetet për disa zyrtar.	Nuk është i aplikueshëm më
3.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të inicojë procedurat për të bërë interpretim dhe vlerësim të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore në lidhje me pensionet e dyfishta.	Ka përmirësime me vitin e kaluar.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të analizojë në hollësi çështjen e pagesave më sipër dhe të shqyrtoj mundësitë për kthimin e tyre nga shfrytëzuesit në llogarinë e buxhetit. Gjithashtu duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet databazave të skemave pensionale.	Ka përmirësime me vitin e kaluar.	Pjesërisht i zbatuar
5.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i tyre bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate. Po ashtu, pagesat me vendime gjyqësore duhet të realizohen nga kategoria adekuate e shpenzimit.	Edhe këtë vit kemi hasur në raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Pasuritë	Ministri, duhet të siguroj përmes drejtorëve të agjencive përkatëse që para përgatitjes së pasqyrave financiare të MFPT-së të bëhet inventarizimi i plotë i pasurisë si dhe krahasimi i gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurive në mënyrë që të bëhen korigjimet e nevojshme për një prezantim të saktë dhe të plotë të pasurive në PFV.	Edhe në vitin 2024 ka mangësi në inventarizim të pasurisë.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri, duhet të siguroj koordinim në mes të njësive në kuadër të ministrisë me qëllim që regjistrat e llogarive të arkëtueshme të mbahen të saktë dhe të azhurnuar, në mënyrë që me rastin e konsolidimit të PVF-ve shënimet të prezantohen saktë.	Janë ndërmarrë veprimet e duhura dhe këtë vit nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar

8.	Llogaritë e arkëtueshme	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime më efektive në inkasimin e këtyre borxheve. Për më tepër, përpjekje shtesë nevojiten në trajtimin e stokut të borxheve të vjetra bazuar në kërkesat ligjore përkatëse.	Ka një efikasitet në mbledhjen e të arkëtueshmëve të reja por që trajtimi i stokut të borxheve të vjetra dhe veprimet në lidhje me to po ndikojnë në rritjen e tyre si rezultat i aplikimit të interesit në sistem.	Pjesërisht i zbatuar
9.	Detyrimet Kontigjente	Ministri, përmes drejtuesve të agjencive duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.	Në Doganë dhe në ATK është implementuar rekomandimi perderisa në administratën e MFPT nuk është implementuar.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Alban Beka, Udhëheqës i ekipit



Flora Berisha, Anëtare e ekipit



Veton Misiri, Anëtar i ekipit



Arnisa Aliu, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: 18.06.2025			
Nivela Org. Org. Unit	Shif. Klasif. Class. Code	No. Prof. Prof. No.	No. Stranica No. Pages
03	47	1057	1



01/150	1850/2025
19.06.2025	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

DATË/A:	18.06.2025
REFERENCË:	/ 2024
PËR/ZA/TO:	z. Faruk Rrahmani, Drejtor i Departamentit të Auditimit Zyra Kombëtare e Auditimit
CC:	z. Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	z. Hekuran Murati, Ministër i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër konfirmimi për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

I nderuar z. Rrahmani,

Përmes kësaj, konfirmojmë se:

- Kemi pranuar draft Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna pajtohem, dhe nuk kemi ndonjë koment shtesë për përmbajtjen e Raportit;
- Ju njoftojmë se brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit përfundimtar, do t'ju dorëzojmë një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, i cili do të përfshijë edhe afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

Hekuran Murati,

Ministër i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.